



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2026

Shtojca 13.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Data 04/09/2026

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE)

☐

ose

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) X

“PRO GREEN” Shpk, me Nuis M11517040F dhe me adrese Rruga "Kavajes", Qendra "Sun Tower", Kati 9, Ap.38, Tirane & “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” Shpk, me Nuis K82230002K dhe me adrese Rruga “Tepelene-Progonat”, Vendndodhja “Skaranë”, ngastra nr. 80 d, Kod kadastral, Gj 3400080d rl, zk. 1149, Tepelene, Gjirokaster & “DESARET COMPANY” Shpk, me Nuis K01816001J dhe me adrese Njesia Bashkiake nr. 11, Rruga “Hysni Gerbolli”, Pallati “Desaret”, Prane Kryqit te Kuq, Kati perdhe, Tirane,

OE “PRO GREEN” Shpk, me pjesemarrje prej 30.5 %

OE “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” Shpk, me pjesemarrje prej 44.8 %

OE “DESARET COMPANY” Shpk, me pjesemarrje prej 24.7 %

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO X

Tipi i Kontratës: Pune.

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur.

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: REF-94916-07-30-2026.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksioni i Shkolles 9-vjecare "Marash Gjoni", Rrile, Nj.A. Shenkoll”.

Kohëzgjatja e kontratës: 21 muaj nga data e nenshkrimit te kontrates.

Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 28/08/2026.

¹Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini Nr. 55, datë 31 Gusht 2026.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori Ekonomik “2Z KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis J63229466K dhe me oferte ekonomike 228,458,123 (dyqind e njezet e tete milion e katerqind e pesedhjetë e tete mije e njeqind e njezet e tre) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

- 2- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “C O L O M B O” Shpk, me Nuis J82916489E & “AGI KONS” Shpk, me Nuis K21622001M dhe me oferte ekonomike 204,221,430 (dyqind e kater milion e dyqind e njezet e nje mije e katerqind e tridhjetë) Lek pa Tvsh,
OE “C O L O M B O” Shpk, me pjesemarrje prej 24.64 %
OE “AGI KONS” Shpk, me pjesemarrje prej 75,36 %

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

- 3- Operatori Ekonomik “INA” Shpk, me Nuis J61814009W dhe me oferte ekonomike 224,703,216 (dyqind e njezet e kater milion e shtateqind e tre mije e dyqind e gjashtembedhjetë) Lek pa Tvsh,
-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:
PO ☐ JO X

- 4- Operatori Ekonomik “NDREGJONI” Shpk, me Nuis K31329048I dhe oferte ekonomike 232,487,533 (dyqind e tridhjetë e dy milion e katerqind e tetedhjetë e shtate mije e peseqind e tridhjetë e tre) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

- 5- Bashkimi I Operatoreve Ekonomik “PRO GREEN” Shpk, me Nuis M11517040F & “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” Shpk, me Nuis K82230002K & “DESARET COMPANY” Shpk, me Nuis K01816001J dhe me oferte ekonomike 219,935,005 (dyqind e nentembehjete milion e nenteqind e tridhjte e pese mije e pese) Lek Pa Tvsh,

OE “PRO GREEN” Shpk, me pjesemarrje prej 30.5 %

OE “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” Shpk, me pjesemarrje prej 44.8 %

OE “DESARET COMPANY” Shpk, me pjesemarrje prej 24.7 %

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

- 6- Operatori Ekonomik “Shendelli” Shpk, me Nuis K07924803N dhe me oferte ekonomike 235,808,958 (dyqind e tridhjte e pese milion e teteqind e tete mije e nenteqind e pesedhjte e tete) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “C O L O M B O” Shpk, me Nuis J82916489E & “AGI KONS” Shpk, me Nuis K21622001M,

OE “C O L O M B O” Shpk, me pjesemarrje prej 24.64 %

OE “AGI KONS” Shpk, me pjesemarrje prej 75,36 %

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se BOE:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.10/7 te DST-se ku parashikohet se: **“2.3.10 Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:**

2.3.10/7 Per Materialet Elektronike:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.

Nga analizimi i Dokumentave standarte te tenderit verehet se per vendosjen e ketij kriteri Autoriteti Kontraktor eshte bazuar ne zerat e preventivit te punimeve qe do te realizohen dhe rendesise se vecante te objektit te prokurimit duke vleresuar si te nevojshme qe mallrat qe do te perdoren ne

realizimin e punimeve te furnizohen nga prodhues apo distributor te autorizuar, kjo ne perputhje me kerkesat ligjore te parashikuara ne pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe ne nenin 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Sa analizuam me siper dhe pas shqyrtimit te kriterit dhe qellimit te vendosjes se tij nga ana e Autoritetit Kontraktor, KVO veren se per permbushjen e ketij kriteri OE-te ne rast se ***nuk jane prodhues*** duhet te paraqesin per “ ***Materialet Elektronike***”, ***kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar***.

Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër qe provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operoret ekonomike duhet te paraqesin per secilin nga materialet e kerkuar: Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër qe provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se per “***Materialet Elektronike***”, BOE ka paraqitur kontrate furnizimi me nje subjekt (furnizues) i cili nuk eshte prodhues por eshte paraqitur ne rolin e Distributorit te Materialeve Elektrike per te cilin edhe ne Autorizimin e Distributorit deklaroi se

“Shoqeria eshte distributor i autorizuar ne Shqiperi per pajisjet elektrike sipas preventivit te punimeve per tenderin me objekt si mësipër, ku ndër të tjera përfshihen materiet elektrike sipas listës bashkëngjitur”

Sa me siper, KVO veren se shoqeria e paraqitur ne rolin e “Distributorit te Autorizuar nga prodhuesi” ka deklaruar se **eshte distributor i autorizuar ne Shqiperi per pajisjet elektrike dhe per rrjedhoje nuk eshte distributor per “Materialet Elektronike”**.

Po ashtu nga verifikimi ne SPE, verehet se bashkëngjitur, BOE ka paraqitur kontrate furnizimi me kete shoqeri qe eshte ne rolin e “Distributorit te Autorizuar” por nga analizimi dhe permbajtja e kesaj marreveshje verehet se te gjitha detyrimet ndermjet paleve i referohen furnizimit me materiale betoni ku ndër të tjera citohet se “*Furnizuesi i siguron Porositësit se furnizimi i betonit do të jetë në përputhje me kushtet e Kontratës sipas markave te caktuara ne porosi*”

Sa me lart, sjellim ne vemendje se edhe **Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin Nr. 825/2021**, gjykon se per te permbushur qellimin e vendosjes se kriterit duhet te parashikohen forma apo dokumentacione alternative provuese te cilat vertetojne lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar nga prodhuesi.

Gjithashtu **KPP** ka mbajtur te njejtin qendrim edhe ne **vendimin Nr. 604/2019**, ne te cilin thekson se : - **“KPP gjykon se mungesa e dokumentit autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi nga kompanitë ADINNOL”, “CHAMPION”, “RAVENOL”, “CASTROL”, “MOTUOL”, “CYCLO” dhe “CHIMITEX, për të cilat janë paraqitur katalogë teknikë bën që dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi të mos jetë i plotë për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret nuk krijohet bindja mbi origjinalitetin e disa prej produkteve objekt prokurimi pasi për to janë paraqitur vetëm katalogë të prodhuesve të ndryshëm nga të cilët ankimuesi nuk ka asnjë autorizim apo dokument që të provojë lidhjen mes tyre”**

- **“KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto rrethana, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga “Alstezo” sh.p.k. nuk është i plotë dhe i saktë dhe nuk krijon bindjen mbi origjinalitetin për një pjesë të mallrave objekt prokurimi”.**

Sa me sipër duke qenë se furnizuesi i paraqitur nga BOE për **“Materialet Elektronike”** rezultoi **distributor i autorizuar në Shqipëri për pajisjet elektrike dhe jo për materiale elektronike** ky kriter konsiderohet i papërbushur.

Komisioni i Vleresimit të Ofertave rithekson bindjen e tij se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i plotësimi të kriterëve të vecanta të paraqitura në DST, për tu përmbushur njësor nga të gjithë Operatorët Ekonomik pjesëmarrës është **i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në ligjmerinë dhe efikasitetin e procedurës**, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si **lex specialis** mbi lëndën.

Se dyti, nuk plotëson kriterin 2.3.10/10 të DST-se ku parashikohet se: **“2.3.10 Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë kontratë e furnizimit për materialet si më poshtë:**

2.3.10/10 Për Pllaka dhe mermer

- **Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.**

Nga analizimi i Dokumentave standarte të tenderit verëhet se për vendosjen e këtij kriteri Autoriteti Kontraktor është bazuar në zërat e preventivit të punimeve që do të realizohen dhe rendesise të vecanta të objektit të prokurimit duke vlerësuar si të nevojshme që mallrat që do të perdoren në realizimin e punimeve të furnizohen nga prodhues apo distributor të autorizuar, kjo në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për

prokurimin publik” dhe ne nenin 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Sa analizuam me siper dhe pas shqyrtimit te kriterit dhe qellimit te vendosjes se tij nga ana e Autoritetit Kontraktor, KVO veren se per permbushjen e ketij kriteri OE-te ne rast se ***nuk jane prodhues*** duhet te paraqesin per ***“Mermer”, kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar***.

Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatorët ekonomike duhet te paraqesin per secilin nga materialet e kerkuar: Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se per ***“Mermerin”***, BOE ka paraqitur nje dokument “Autorizim Prodhuesi” i hartuar nga nje subjekt (furnizues).

Nisur nga dokuemnti i paraqitur ne SPE “Autorizim Prodhuesi” nga subjekti (furnizues), KVO duke pasur ne konsiderate se te gjithë prodhuesit e kane detyrim ligjor pajisjen me leje mjedisore nga QKL, beri nje kerkim ne faqen zyrtare qkb.gov.al, ku rezultoi se furnizuesi per ***Mermerin*** nuk disponon QKL si prodhues.

Po ashtu, KVO veren se OE nuk ka paraqitur per furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit.

Theksojme se ushtrimi i aktivitetit te prodhimit pa u pajisur paraprakisht me licensen perkatese eshte ne kundërshtim me percaktimet ligjore dhe cdo subjekt qe ushtron aktivitet prodhimi ne kundërshtim me ligjin nuk mund te konsiderohet prodhues.

Sa me lart, sjellim ne vemendje se edhe **Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin Nr. 825/2021**, gjykon se per te permbushur qellimin e vendosjes se kriterit duhet te parashikohen forma apo dokumentacione alternative provuese te cilat vertetojne lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar nga prodhuesi.

Gjithashtu **KPP** ka mbajtur te njejtin qendrim edhe ne **vendimin Nr. 604/2019**, ne te cilin thekson se : - ***“KPP gjykon se mungesa e dokumentit autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi nga kompanitë ADINNOL”, ”CHAMPION”, “RAVENOL”, “CASTROL”, “MOTUOL”, “CYCLO” dhe “CHIMITEX, për të cilat janë paraqitur katalogë teknikë bën që dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi të mos jetë i plotë për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret nuk***

krijohet bindja mbi origjinalitetin e disa prej produkteve objekt prokurimi pasi për to janë paraqitur vetëm katalogë të prodhuesve të ndryshëm nga të cilët ankimuesi nuk ka asnjë autorizim apo dokument që të provojë lidhjen mes tyre”

-“KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto rrethana, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga “Alstezo” sh.p.k. nuk është i plotë dhe i saktë dhe nuk krijon bindjen mbi origjinalitetin për një pjesë të mallrave objekt prokurimi”.

Sa me sipër duke qenë se furnizuesi i pretenduar nga Operatori Ekonomik për **Mermerin** nuk disponon dhe nuk rezulton në Qendren Kombëtare të Licensimit të jetë i paisur me leje mjedisi si prodhues si dhe duke qenë se nuk ka paraqitur për furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis tij dhe ndonjë prodhuesi ky kriter konsiderohet i papërbushur.

Komisioni i Vleresimit të Ofertave rritet bindjen e tij se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i plotësimin të kriterëve të vecanta të paraqitura në DST, për tu përbushur njësor nga të gjithë Operatorët Ekonomik pjesëmarrës është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në ligjmerinë dhe efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur nën 77, pikë 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nën 92, pikë 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të

këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e BOE “C O L O M B O” Shpk, me Nuis J82916489E & “AGI KONS” Shpk, me Nuis K21622001M, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, BOE “C O L O M B O” Shpk, me Nuis J82916489E & “AGI KONS” Shpk, me Nuis K21622001M, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatoreve Ekonomik “PRO GREEN” Shpk, me Nuis M11517040F dhe me adrese Rruga "Kavajes", Qendra "Sun Tower", Kati 9, Ap.38, Tirane & “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” Shpk, me Nuis K82230002K dhe me adrese Rruga “Tepelene-Progonat”, Vendndodhja “Skaranë”, ngastra nr. 80 d, Kod kadastral, Gj 3400080d rl, zk. 1149, Tepelene, Gjirokaster & “DESARET COMPANY” Shpk, me Nuis K01816001J dhe me adrese Njesia Bashkiake nr. 11, Rruga “Hysni Gerbolli”, Pallati “Desaret”, Prane Kryqit të Kuq, Kati perdhe, Tirane se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 219,935,005 (dyqind e nentembedhjetë milion e nenteqind e tridhjetë e pese mije e pese) Lek Pa Tvsh është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë zyres së protokollit të Bashkisë Lezhe sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet siguri i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO ☒

Nëse Po (Nr.____ Datë____ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETARI
Pjerin NDREU